



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE
KOMISIONI I VOTIMIT

VENDIM

PËR REZULTATIN E ZGJEDHJEVE DHE SHPALLJEN E FITUESIT

Në mbështetje të nenit 115 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Votimit me përbërje:

Anila Leka - Kryetar;

Adnan Xholi -Anëtar;

Arben Kraja-Anëtar,

pasi administroi gjithë dokumentacionin e votimit, numëroi votat, përpiloi procesverbalin përkatës,

VËREN:

Në përfundim të procesit të votimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve për zgjedhjen e 1 (një) prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, rezultoi se morën pjesë në votim 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) prokurorë, nga të cilët votuan pro kandidatit z.Vatë Staka 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) prokurorë ndërsa 81 (tetëdhjetë e një) vota janë të pavfeshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 115 paragrafët 5 e 7 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 15 të rregullores së Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve, Komisioni i Votimit,

VENDOSI:

1. Të shpallë fitues prokurorin e prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë Vatë Staka.
2. Ky vendim të shpallet zyrtarisht në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme jo më vonë se 24 orë nga Mbyllja e Mbledhjes së Përgjithshme.
3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 11.04.2019, ora 13.20.

KOMISIONI I VOTIMIT

ANËTAR

ADNAN XHOLI

KRYETARE

ANILA LEKA

ANËTAR

ARBEN KRAJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE
KOMISIONI I VOTIMIT

Tiranë, më 11/04/2019

PROCESVERBAL

**I PROCESIT TË VOTIMIT NGA MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E
PROKURORËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT PROKUROR TË KËSHILLIT
TË LARTË TË PROKURORISË**

Sot, më 11/04/2019, ora 11.04, në Tiranë, mbahet ky procesverbal për të dokumentuar votimin nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarit prokuror për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 115, pika 3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve në përputhje me rendin e ditës, votoi për zgjedhjen e 1 (një) prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Nga lista emërore e nënshkruar vërtetohet se morën pjesë në mbledhje 229 (dyqind e njëzetë e nëntë) prokurorë të të gjithë niveleve.

Votimi nisi në orën 11.43 dhe përfundoi në orën 12.20.

U hap kutia e votimit, duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit.

Nga numërimi rezultoi se numri total i votave të hedhura në kuti është 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë). Nga numri total i votave, rezultoi se 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) vota janë të vlefshme dhe 81 (tetëdhjetë e një) vota janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton se kandidati Z.Vatë Staka, ka marrë 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) vota pro.

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Z. Vatë Staka, zgjidhet anëtar prokuror i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Proceverbali mbahet në 2 (dy) kopje, u lexua e u gjet i rregullt dhe firmoset pa vërejtje nga Komisioni i Votimit.

Proceverbali, vendimi dhe gjithë materialet e votimit i dorëzohen Prokurorit të Përgjithshëm, sot në datë 11.04.2019.

Procesverbali mbyllet në orën 13.14.

KOMISIONI I VOTIMIT

ANËTAR
ADNAN XHOLI



KRYETARE
ANILA LEKA



ANËTAR
ARBEN KRAJA

